

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR

PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA

PER VITIN KALENDARIK 2016

PARTIA " SFIDA PER SHQIPERINE"

Tabela e përmbajtjes

1-Raporti i Auditusit te pavarur.

2-Pozicioni Financiar

3-Pasqyra e Aktiviteteve

4-Pasqyra e fluksit te parase

5-Shenime per pasqyrat financiare

Tirane me 24 Tetor 2017

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Partise "Sfida Per Shqiperine"

Te nderuar Zoterinj ,

Në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin Nr.196 datë 03.05.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Per shpalljen e rezultatit të shortit për emerimin e eksperteve kontabel të licensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2016", dhe në Kontratën e Shërbimit datë 03.10.2017 të lidhur me KQZ, kam kryer auditimin e pasqyrave financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga "Partia Sfida Per Shqiperine" për vitin kalendarik 2016

Opinion

Në kemi audituar pasqyrat financiare të Partise "Sfida Per Shqiperine" të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partise "Sfida Per Shqiperine" më datën 31 dhjetor 2016, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF).

Baza për Opinionin

Në e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Në jemi të pavarur nga Partise "Sfida Per Shqiperine" në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë si dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Në besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK për OJF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Partise "Sfida Per Shqiperine" për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e

zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Partisë” Sfidë Per Shqipërië “ ose të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Partisë “Sfidë Per Shqipërië “.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalië mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbulimin e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe zbulimeve përkatëse të bëra nga Manaxhimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, të zbatuar nga Manaxhimi dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e Shoqërië për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit tek informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare ose, nëse informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese është i pamjaftueshem, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund t'i shkaktojnë Shoqërisë ndërprerjen e vazhdimësisë në përputhje me parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare vjetore, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, si dhe nëse pasqyrat financiare vjetore paraqesin transaksionet dhe ngjarjet kryesore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Partisë “Sfidë Per Shqipërië”, përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikur gjatë auditimit tonë.

Tiranë, 24 Tetor 2017

Alida Daija

Ekspert Kontabel i regjistruar

"ALIDA DAIJA"
EKSPERT KONTABEL
RFCH - TVAR LIC144



Pozicioni Financiar
Per vitin e mbyllur me 31dhjetor 2016
(Te gjitha balancat jane ne leke)

PARTIA "SFIDA PER SHQIPERINE"

Nr	A K T I V E T	Me 31 Dhjetor 2016	Me 31 Dhjetor 2015
I	A K T I V E T A F A T S H K U R T R A		
1	Aktivitet monetare	<u>88,897</u>	<u>0</u>
	> Banka	27,545	
	> Arka	61352	
2	Te drejta dhe interes I arketueshem	0	
3	Parapagim taksa te tjera	0	
4	Inventari		
	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTA	<u>88,897</u>	<u>0</u>
II	A K T I V E T A F A T G J A T A M A T E R I A L E		
1	Toka, Ndertesa, makineri dhe Paisje		-
2	Aktivitet afatgjata te patrupezuara	0	-
4	Totali I Aktive afatgjata materiale(II)	0	-
	TOTALI AKTIVEVE (I+II)	<u>88,897</u>	
Nr	P A S I V E T D H E K A P I T A L I		
I	P A S I V E T A F A T S H K U R T R A		
1	Te pagushme ndaj paleve te treta	54,800	
2	Te pagushme ndaj shtetit	34,084	
3	Kontribute te marra ne avance		
	Totali I Pasiveve afatshkurta (I)	<u>88,884</u>	<u>0</u>
II	P A S I V E T A F A T G J A T A		
1	Grande	-	-
2	Premtime te kushtezuara per te dhene	-	-
	Totali I Pasiveve afatgjata (II)	-	-
	TOTALI PASIVEVE (I+II)	<u>88,884</u>	<u>0</u>
III	A K T I V E T N E T O		
1	Te kufizuara-Toke ose vepra arti te dhuruaraper per tu perdorur per qellime specifike me percaktim	-	-
	qe te ruhen apo te mos shiten		
2	Te kufizuara- aktive te dhuruara me qellimin per investuar dhe siguruar prej tyre burime te perher	-	-
	shme te ardhurash	13	-
3	Te pakufizuara	-	-
	Totali I Kapitalit (III)		
	TOTALI PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)	<u>88,897</u>	<u>0</u>

Pasqyra e Aktiviteteve (performances)
Per vitin e mbyllur me 31dhjetor 2016
(Te gjitha balancat jane ne leke)

PARTIA "SFIDA PER SHQIPERINE"

	Me 31 Dhjetor 2016	Me 31 Dhjetor 2015
Te ardhurat		
Nr Te ardhura nga tarifat e antaresimit	398067	
1 Te ardhura nga grandet qeveritare	-	-
2 Te ardhura nga donacione e te tjera		
3 Te ardhura nga investimet apo dhurimet	-	-
4 Te ardhura te tjera		
Totali i te Ardhurave nga aktivet neto te pakufizuara	398,067	0
Aktivete neto te cliruara nga kufizimet		
1 Realizimi I kufizimeve te programit		
2 Realizimi I kufizimit teblerjeve te paisjeve		
3 Perfundimi I kufizimit te afatit		
Totali I aktiveve neto te cliruara nga kufizimet	0	0
Totali I te ardhurave nga aktivet neto te pakufizuara	0	0
Shpenzimet per aktivitetet		
Shpenzimet per projekte		
Shpenzime administrimi dh te tjera	398,054	
<i>Krijime dhe ritje fondesh</i>		
Totali i Shpenzimeve	398,054	
Ritjs/renia ne aktivet neto te pakufizuara (A)	13	0
Ndryshimi ne aktivet neto te kufizuara		
kontributete	0	0
Te ardhura nga investime afatgjate		
Aktivete neto te cliruara nga kufizimet		
Ritjs/renia ne aktivet neto te perkohshme te kufizuara (B)		
Ndryshimet ne aktivet neto (A+B)		

Pasqyrat e fluksit te Parase
Per vitin e mbyllur me 31dhjetor 2016
(Te gjitha balancat jane ne leke)

PARTIA "SFIDA PER SHQIPERINE"

Nr	Me 31 Dhjetor 2016	Me 31 Dhjetor 2015
I Fluksi i parave nga aktivitetet e shfrytezimit		
Para te arketuara ngakontribute te pakufizuara	398,067	0
Para te arketuara nga perfituesit e sherbimeve		
Grand I pagueshem/kthyeshem		0
Te paguara per punonjesit dhe furnitoret	-309170	
Interes I paguar		
Interes dhe dividend te arketuar		
Flukset neto nga aktivitetet e shfrytezimit	88,897	
II Fluksi parave nga aktivitetet investuese		
Kontribute te kufizuara		
Blerje/shitje investimesh		
Blerje/shitje te aktiveveafatgjata materiale		
Flukset neto nga aktivitetet investuese		
III Fluksi parave nga aktivitetet financiare		
Arketieme ngs kontributet e kufizuara per investime ne dhurime	-	-
Interesa dhe dividente te kufizuara per qellime dhe terma afatgjate	-	-
Flukse neto nga aktivitetet financuese		
IV Mjetet monetare ne fund te periudhes		
Rritja/Renia neto e mjeteve monetare	88,897	
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel		
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	88,897	0

1- INFORMACION I PERGJITHSHEM

Partia "Sfida Per Shqiperine", eshte rregjistruar, me Vendim Nr.7323 date 23.09.2016 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas ketij vendimi, është miratuar krijimi i Partisë, "Sfida Per Shqiperine ", me initiale "SFIDA". Kryetar i saj, është **zoti Hektor Ruçi**.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te Ligjit nr. 8580 , dt.17.02.2000 "Per Partite Politike", Ligjit nr. 8788, dt. 07.05.2001 "Per Organizatat Jofitimpruese", Ligjit 8779, dt. 07.05.2001 "Per Regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese ", nga Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Selia e partise ndodhet ne rrugen "Sami Frasheri Pall Delta", Tirane. "SFIDA" eshte e rregjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Tirane me date 25.10.2016 me NIPT L62226451M.

Qëllimi i krijimit: Qëllimi dhe objektivat e Partisë "Sfida Per Shqiperine janë të përcaktuara në programin dhe Statutin e saj.

Organizimi dhe drejtimi

Organet drejtuese të "SFIDA" janë:

- Kuvendi Kombetar(organ vendimarrës)
- Kryesia e kuvendit kombetar(organ ekzekutiv)
- Komisioni i Etikës
- Komisioni Ankimimit.
- Komisioni Rishikimi Statutor
- Mbajtesi i Thesarit

Burimet financiare të Partisë janë:

- Të ardhurat nga kuotacionet;
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike
- Ndihamat dhe dhurata e anëtarësisë dhe të përkrahësve të Partisë sipas ligjit per partite politike.
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

Baza Ligjore per kryerjen e ketij misioni :

- Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.10374 date 10.02.2011
- Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar",
- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit SNA 700;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë.
- Vendimi nr.196 date 03.05.2017 te KQZ.

-SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

-PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE E RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar,(SKRF) të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,, dhe Planit Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF) në fuqi nga 1 Janar 2016.

Mbi bazën e këtyre parimeve të kontabilitetit, në llogaritë kontabile e në pasqyrat financiare të Partisë , janë evidentuar e deklaruar si shpenzime edhe faturat e pranuar, por të papaguara, ndaj furnitorëve të ndryshëm, për shërbimet e përfituara gjatë vitit 2016. Këto veprime, janë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, të dala në zbatim të tij

Bazat e matjes.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, SFIDA parashikon se veprimtaria e saj do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

Kontabiliteti është ndërtuar mbi bazën e parimeve të konstatimit. Sipas kësaj mënyre, fondet e përfituara në të holla, janë regjistruar në momentin e arkëtimit të tyre dhe fondet e përfituara në natyrë dhe shërbimet në momentin e kryerjes, duke i konvertuar në lekë me çmimin e tregut dhe shpenzimet janë pasqyruar në momentin e konstatimit të tyre kur janë kryer.

Administrimi i fondeve të përfituara dhe shpenzimet e kryera, janë të përqëndruara, në Seline e Partisë.

Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Subjektit janë prezantuar në Lekë shqiptar (Lekë), e cila është monedha funksionale. Te ardhurat dhe shpenzimet e emëtuara në monedha të huaja, janë konvertuar në Lekë, bazuar në kursin e këmbim të datës që është kryer transaksioni.

Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

Parimet kontabël kryesore të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Burimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë njohur mbi bazën e parimit të të drejtave të konstatuara, për kuotën e anetaresimit vjetore për çdo anëtar .

Përdorimet e fondeve të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e kryera për vitin 2016, dhe shpenzimet e kryera për vitin 2016, por që nuk janë paguar në fund të vitit.

Tatimi mbi fitimin

“SFIDA” është organizatë jofitimprurës. Si i tillë, Partia nuk paguan tatim mbi fitimin. SFIDA respekton dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin në burim.

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme në fund të vitit janë paraqitur me koston e tyre historike. Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale, të lëshuara nga klientët apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentave origjinale kontabël.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë gjendjen në arkë, llogaritë rrjedhëse në para në banka.

Teprica dhe defiçiti i burimeve

Teprica / defiçiti midis burimeve dhe përdorimeve, që krijohet gjatë vitit, pasqyrohet në pasurinë neto të Partise

Kontributet për sigurimet dhe Fondi i pensioneve

Partia paguan kontributet për pensione si dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe

sigurimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe sigurimet shëndetësore.

Per te dale ne konkluzione sa me te sakta auditori, ne kuadrin konceptual te te ardhurave dhe shpenzimeve, mori ne konsiderate ngjarje dhe fakte ekonomike financiare qe i takojne gjithe periudhes ushtrimore, 25 Tetor deri me 31 dhjetor 2016. Auditimi i situates financiare mori per baze gjitha dokumentacionin kontabel te mbajtur dhe raportuar gjate dhe ne fund te vitit 2016, rregjistrat kontabel si dhe gjithe dokumentacionin e nevojshem , gje qe mundesoi dhe krijimin e opinionit te Audituesit te Pavarur .

Mjete monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

Banka	27.545 leke
Arka	61.352 leke
Totali	88.897 leke

Gjëndjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat e pozicionit financiar janë të njëjta me të dhënat e llogarive rrjedhëse dhe konfirmohen nga nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë konvertuar në lekë duke përdorur kursin e këmbimit.

Partia ka llogari bankare ne BKT dhe ne Raiffeisen Bank.

Detyrimet Afatshkurtera

Teprica e Detyrimet Afatshkurtera per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2016 paraqitet si me poshte:

-Te pagushme ndaj paleve te treta	54.800 leke
-Te pagushme ndaj shtetit	34.084 leke

Totali 88.884 leke

Te pagushme ndaj paleve te treta pefaqesojne deturime ndaj furnitoreve ne shumen 4.800 leke(Albtekom) dhe paga e punonjesve ne shumen 50.000leke Te pagushme ndaj shtetit perfaqesojne detyrimet per sigurimet shoq dhe shendetsore, TAP dhe Tatim ne Burim te muajit dhjetor 2016 respektivisht ne shumat 17.281 leke,8.448 dhe 8.355 leke.

Te ardhura dhe shpenzime

Te ardhurat dhe shpenzimet evidentohen ne nje rrjet te detajuar llogarish te cilat mundesojne kontrollin dhe marrjen ne kohe te informacionit.

Te Ardhurat

Partia "SFIDA PER SHQIPERINE" gjate vitit 2016 ka realizuar te ardhura si me poshte:

1-Te ardhura nga kuotat e anetaresimit ne shumen 398.067 leke
Burimi e te ardhurave eshte krijuar nga burime te ligjshme

Te ardhura nga donacionet.

Gjate vitit 2016, Auditi nuk ka konstatuar te ardhura nga donacionet ne para apo ne natyre.

Kredi ,garanci te ndryshme .

Gjate vitit 2016 Partia nuk ka marre kredi apo garanci te ndryshme nga banka dhe institucione te tjara finsnciare,apo te trete.

Shpenzimet .

Konsumi i materialeve, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e personelit, paga dhe sigurimet shoqerore jane pasqyruar saktesisht si shpenzim ne vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

Shpenzime personeli

Teprica e shpenzime personeli per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2016 paraqitet si me poshte:

-shpenzime per paga	121.636 leke
-shpenzime per sig shoqerore dhe shendetsore	22.122 lek
Totali	143.758 leke

Furnitura ,nentrajtme dhe sherbime

Teprica e furniturave, nentrajtme dhe sherbime per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2016

-Taksat Vendore	3.750
-Qera zyre	167.579
-Interesa dhe komisione benkare	2.660
-shpenzime administrative	80.410
-Diferenca kursi	(102)
Totali	254.297 leke

Auditimi i shpenzimeve u realizua ne analize te tyre ne krahasim me dokumentin justifikues te paraqitur nga subjekti.

Në tërësi, shpenzimet janë të dokumentuara me fatura tatimore , si dhe janë të evidentuara në pajtim me rregullat dhe standartet kontabile që zbatohen në Shqipëri.

Alida Daija
Eksperte Kontabel e Rregjistruar


"ALIDA DAIJA"
EKSPERT KONTABEL
NR.001 "1999" LIC144